

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.965/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm- Gjyqtari i vetëm gjykues Gëzim Ademi, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri, në çështjen penale kundër të pandehurit: M.H me vendbanim ne fsh. ... rr. "...", për shkak te veprës penale: Pengim i personit zyrtar ne kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par.5 ne lidhje me par. 1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë PP-II.nr.1040/2012 te datës 02.11.2018, ne mungese te PTH. Natasha Taniq, ne prezencë te te pandehurit me datën 15.02.2019 ka shpallur publikisht, ndërsa me 27.02.2019 ka përpiluar këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: M.H , nga i ati K., e ëma H., e vajzërisë Sh., i lindur me ... me vendbanim fsh. ... rr. "...” nr. ...- ..., me nr. Personal ..., ka te kryer shkollën fillore, i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptar , Shtetas i Republikës se Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me 14.11.2012 rreth orës 11:00 ne rrugën regjionale ...-..., ne fsh. ... ka penguar personat zyrtar K.Sh dhe N.K- zyrtar i doganës ne kryerjen e detyrës zyrtare te cilën kane qene duke e kryer ne njësinë mobile te doganës se Kosovës ne parandalimin e mallrave te kontrabanduara, ashtu qe ne fsh. ..., KK. E ..., është kyçur ne rruge me xhipin e tij te markës BMW me tab. Regjistrimit ..., ne mes te veturës zyrtare ku kane qene doganieret dhe kamioni i markës VW me tab. Regj. ... e te cilët me herët i janë vene ne ndjekje pas kamionit te cekur i cili ka transportuar mall te kontrabanduar, me rotacionin dhe sinjalizimin me zë te ndezur derisa i pandehuri me veturën e vet ia ka pamundësuar qe te njëjtët te kryejnë detyrën zyrtare duke vozitur tere kohës ne mes te rrugës e me qellim te pengimit te te njëjtave ne kryerjen e detyrës zyrtare.

Me këtë ka kryer veprën penale- **Pengimi i personit zyrtar ne kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par.5 ne lidhje me par. 1 te KPRK-se**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,46,73, dhe 409 par 5 ne lidhje me par. 1 te KPRK-ës dhe nenit 365, 450,463 te KPP-ës e:

G J Y K O N

ME DENIM BURGU ne kohëzgjatje prej 6 muaj

Pas shpalljes se aktgjykimit i pandehuri ka dhëne pëlqimin qe dënimi me burg te zëvendësohet me dënim me te holla.

Gjykata duke u bazuar ne dispozitat e nenit 47 te Kodit te Republikës se Kosovës

Dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6(gjashte) muajve ia ZAVENDESON ME DENIM ME GJOBË ashtu qe i pandehuri M.H obligohet qe te paguaj ne emër te gjobës shumen prej 2.000(dymijë) euro ne afat prej 15 ditëve prej ditës se marrjes se formës se prere te aktgjykimit.

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, ndërsa ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimin shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike-kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil .

A r s y e t i m

I. Aktakuza

Prokuroria Themelore ne Mitrovice ka ngritur aktakuze PP-II.nr.1040/2012 te datës 02.11.2018, kundër te pandehurit M.H, për shkak te veprës penale: Pengimi i personit zyrtar ne kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par.5 ne lidhje me par.1 të KPRK-ës.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 15.02.2019 ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: e pranoj fajësinë për veprën penale qe me vihet ne barre dhe me nuk po te përsëris asnjëherë vepër penale, këtë e bëjë me vullnet dhe pa presionin e askujt.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurorja deklaroi se janë plotësuar te gjitha kushtet për pranimin e fajësisë ku i pandehuri vullnetarisht ka pranuar fajësinë për këtë shkak i propozon gjykatës qe te pranohet nga ana e te pandehurit dhe te merret parasysh si rrethane lehtësuese me rastin e vlerësimit te lartësisë se dënimit.

II. Vlerësimi i pranimi te fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me neni 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare, pas sqarimeve te mjaftueshme nga ana e gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënin te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimi te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban akuza, te gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë ne përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat qe gjenden ne shkresat e lendes si: Raporti policor ... i dt. 14.11.2012, deklarata e te pandehurit dt.22.11.2012, deklarata e dëshmitarit e dt. 22.10.2012, deklarata e dëshmitarit dt.22.10.2018 si dhe CD incizimit dhe foto dokumentacioni i shkresave te lendes. Nga te gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e te pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: **Pengim i personit zyrtar ne kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par.5 ne lidhje me par. 1 të KPRK-ës**

III. Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e dënueshme me dënim me burgim prej 1(një) deri ne 5 (pese) vjet, andaj duke vlerësuar

rrethanat lehtësuese dhe renduese, kjo gjykate si rrethana renduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat ne te cilat ishte kryer vepra penale.

Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e qe nga deklarimi i tij me rastin e pranimit te fajësisë rezulton se i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tille i te pandehurit për gjykatën shpreh një pendim te thelle te tij për veprën penale.

Nga te gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrethana te tilla mjafton dënimi me gjobe, nga se do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënimit me kusht. Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes se dënimit, bazuar ne nenin 75 paragrafi 1 nën paragrafi 3 i KPRK-ës, ku kjo dispozite ka parapare se ndaj te pandehurit qe ka pranuar fajësinë gjykata munde te aplikoj dispozitat zbutjes se dënimit, prandaj kjo gjykate duke aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit i ka shqiptuar dënimin me burgim nen minimumin e veçantë ashtu qe ka caktuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 6 muaj, ne mbështetje te nenit 47, këtë dënim ndaj te pandehurit me pëlqimin e tije e ka zëvendësuar me dënim me gjobe, ashtu qe ka përcaktuar dënimin me gjobe ne shume prej dymijë euro, i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nga te gjitha këto rrethana kjo gjykate vlerëson e edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurit

IV. Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, ndërsa ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

V. Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450,463, te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.965/18 dt.27.02.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate.